

VENDIM
Nr. 97/2014

**PËR PROCEDURËN PARAPRAKE PËR PËRZGJEDHJEN E INSPEKTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, nenit 111, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 54, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e procedurës paraprake për përzgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, sipas fazave të mëposhtme:

a) Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën e pozicionit të Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik). Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit/kandidatëve për përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe pëlqimi i kandidatit /kandidatëve me shkrim. Afati i dorëzimit të dokumentacionit të bëhet brenda 10 ditëve nga publikimi.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara, u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjuesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare, për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjësës publike, të paktën 28 deputetë, përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t’ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake e propozuar në pikën I, të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t’u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast që të paktën 28 deputetë t’i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 4.12.2014